



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.256/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Shoqëria “MIGROS-Group” Sh.p.k, me NUI: 810820771, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit “Bardhi & Partnerët” në Prishtinë, kundër debitorit Shoqëria “Tasty Exclusive” Sh.p.k, me NUI: 811570408, me seli në rrugën “Dëshmorët e Kombit” p.n – Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson R.N. - Drejtor Menaxhues i Shoqërisë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.23/22 të datës 03.02.2022 të Përmbartuesit Privat Irfan Kërcagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 09.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Shoqëria “Tasty Exclusive” Sh.p.k, i paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.23/22 të datës 03.02.2022 të Përmbartuesit Privat Irfan Kërcagu.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.23/22 i datës 03.02.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan Kërcagu.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Shoqëria “MIGROS-Group” Sh.p.k, ka caktuar urdhrin P.Nr.23/22 me datën 03.02.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit i Kartelës Analitike i Debitorit të datës 31.01.2022 dhe Faturës Nr.21-PF1-H001-507062 e datës 08.10.2021 me vlerë 253.12 €, Nr.21-PF1-001-507064 e datës 08.10.2021 me vlerë 1,049.36 €, Nr.21-PF1-H001-507-66 e datës 08.10.2021 me vlerë 31.56 €, Nr. 21-PF1-H001-507067 e datës 08.10.2021 me vlerë 444.46 €, Nr.21-PF1-H001507073 e datës 08.10.2021 me vlerë 180.34 €, Nr.21-PF1-M158-502952 e datës 09.10.2021 me vlerë 276.41 €, Nr.21-PF1-M158-502953 e datës 09.10.2021 me vlerë 183.35 €, Nr.21-PF1-M158-502954 e datës 09.10.2021 me vlerë 242.34 €, 21-PF1-M158-502956 e datës 09.10.2021 me vlerë 134.67 €, Nr.21-PF1-M169-501894 e datës

09.10.2021 me vlerë 844.54 €, Nr.21-PF1-M169-501895 e datës 09.10.2021 me vlerë 771.75 €, Nr.21-PF1-H169-501897 e datës 09.10.2021 me vlerë 448.83 €, 21-PF1-M169-501900 e datës 09.10.2021 me vlerë 278.07 €, Nr.21-PF10M169-501901 e datës 09.10.2021 me vlerë 12.75 €, 21-PF1-M197-501134 e datës 09.10.2021 me vlerë 451.59 €, Nr.21-PF1-M197-501135 e datës 09.10.2021 me vlerë 330.50 €, Nr.21-PF1-M1970501136 e datës 09.10.2021 me vlerë 339.68 €, Nr.21-PF1-M197-501137 e datës 09.10.2021 me vlerë 215.85 €, Nr. 21-PF1-H001-507133 e datës 10.10.2021 me vlerë 57.60 €; ku e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave së lartcekura, të ia paguaj kreditorit shumën prej 6,546.77 €, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturës deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe ato të përmbaruesit privat me bllokimin e të gjitha llogarive të debitorit, regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit në masën pasurore deri në përmbushjen e obligimit në tërësi, në llogarinë bankare të kreditorit Nr.... tek ProCredit Bank-Prishtinë.

Debitori përmes të autorizuarit të tij në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se urdhri përmbarimor i lëshuar nga përmbaruesi privat nuk i ka tiparet e përmbarueshmërisë (nuk ka efekt të titullit ekzekutiv – përmbarues), duke theksuar se në bazë të propozimit të përmbarimit kreditorit nuk e sqaron mbi bazën e cilave dokumenteve e ka propozuar përmbarimin, dhe cilat janë ato dokumente të besueshëm që Organi Përmbarues duke mos listuar asnjë nga Faturat ose Ekstrakti i Kartelës Analitike të debitorit, në këtë pikë vetëm propozohet që në emër të borxhit të arritur për pagesë të detyrohet debitorit që t’ia paguaj shumën prej 6,546.77 €. Në pikën tjetër, mungon propozimi për veprime të mëtutjeshme të Organi Përmbarues dhe mënyra se si të veprohet në procedurën e përmbarimit të dhunshëm, gjithashtu vazhdo dështimi i kreditorit duke mos propozuar Organi Përmbarues që nëse debitori nuk e paguan detyrimin të caktohet përmbarim i dhunshëm në llogaritë bankare të debitorit. Gjithashtu kemi të bëjmë me shkeljen e nenit 17 të LPP-së lidhur me nenin 182.2 të LPK-së, pasi që Organi Përmbarues nuk ka autoritetin por as kompetencën që të marrë veprimet jashtë propozimit të kreditorit, dhe çdo veprime i Organit Përmbarues pa përfshirjen e BQK-së konsiderohet veprime të kundërligjshme. Ekstrakti i Kartelës Analitike nuk është Dokument i besueshëm duke mos pasur bazë ligjore sipas neneve të LPP-së edhe nëse ky pretendim bazohet në nenin 29 pika 1.2 i LPP-së, dështim tjetër i këtij urdhëri përmbarimor përfshihet në nenin tjetër të LPP-së, pra nenin 30 ku e bënë këtë urdhër si jo ligjor dhe në kundërshtim me këtë nen pasi që mungon Deklarata se Kredia është e Kërkueshme – pra nëse është kërkuar ekzekutimi

e pagesës nga debitori. Fakt tjetër që e kundërshtojmë është se faturat nuk janë pranuar me rregull nga ana e debitori, me përjashtim të 5 faturave të datës 07.10.2021 të gjitha faturat të tjera nga 19 faturat gjithsej, 14 prej tyre nuk duhet se kush i ka pranuar dhe nuk janë pranuar asnjëherë nga debitori, pasi dëshmohet edhe me mungesën e vulës së debitorit dhe në fund propozimi për përmbnim, është iniciuar nga personi i pa autorizuar dhe në këtë rast nuk ka pasur të drejtë që të ndërmar veprim të tillë. Andaj i ka propozuar Gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet ekzekutimi i urdhrit përmbnimor P.nr.23/22 i datës 03.02.2022, të caktohet seancë dëgjimore dhe të abrogohen vendimet e marra në këtë çështje përmbnimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes të autorizuarit të tij, ndër të tjera ka deklaruar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, pasi që fatura e dorëzuar i ka të gjitha tiparet e dokumentit të përmbnueshëm dhe shpjegimi në prapësim të debitorit është absolut i pa bazë dhe i pa qëndrueshëm se gjoja kredia e cila kërkohet duhet të jetë e kërkueshme ose jo, kjo për faktin se debitori ka qenë në dijeni se çmimi në emër të mallit të vlerë nga kreditori, objekti lëndor i këtij kontesti, duhet paguar më së shumti brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të mallit në fjalë dhe për këtë e ka konfirmuar përmes emailit me datën 21 janar 2022 për detyrimin e pagesës së borxhit dhe nuk ka pasur asnjë formë të kundërshtimit nga ana e debitorit. Gjithashtu kreditori ka konfirmuar se deri në ditën e ushtrimit të përgjigjes në prapësim pa ndonjë arsye nuk i ka paguar shumë vet konfirmuar prej 1,650.00 €. Pretendimi i debitorit në prapësim se vetëm 5 fatura bashkangjitur në propozim për përmbnim kanë formën e duhur ligjor, ndërsa faturat e tjera (14 nga 19 gjithsej sa kanë qenë), ju mungon vula e debitorit dhe nënshkrimi, nuk ka asnjë domethënie dhe rëndësie të veçanti juridike, pasi që kreditori sqaron se fatura janë të nënshkruara dhe të vërtetuara nga dorëzues dhe pranuesi i mallrave dhe të vulosura dhe të nënshkruara si nga kreditori edhe nga debitori dhe personeli i pikave Shitëse (MARKETI) ku fizikisht nuk kanë poseduar vulën të Kompanisë-DEBITORI. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, dhe të mbete në fuqi urdhri përmbnimor P.nr.23/22 të datës 03.02.2022.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbnimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbnim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnimit me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbnimit për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbnuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht faturat e lartcekura të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 dhe 1.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj marrëveshje afariste, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit si dhe të njëjtat nuk janë kontestuar nga ana e debitorit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbnimore, vlerëson se urdhri për përmbnim i lejuar mbi bazën e dokumenteve të besueshme nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbnimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbnimore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, bazuar në nenin 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.256/22, datë 09.08.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.